



SHLUIJ “UNIVERSITETI
MARIN BARLETI”

KODI I ETIKËS

Qëllimi i këtij Kodi është të respektojë lirinë akademike, të ruajë standarde të larta etike në procesin e mësimdhënies dhe të përmbushjes së misionit të Universitetit.

Me përkushtimin për të ruajtur e rritur më tej vlerësimin pozitiv dhe autoritetin publik që gëzon Universiteti Marin Barleti (në vijim Universiteti) dhe standardet e larta të drejtimit, integritetit dhe drejtësisë, stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët e Universitetit, nëpërmjet këtij Kodi, premtojnë të njohin dhe të ruajnë parimet e mëposhtme:

KREU I

Stafi akademik, stafi administrativ dhe studentët

1. Parimi i legjitimitetit në punë:

Çdo anëtar i Universitetit është i detyruar të punojë, të studjojë dhe të veprojë në përputhje me ligjet përkatëse, aktet nënligjore, Statutin dhe aktet e tjera të Universitetit.

2. Parimi i integritetit:

Çdo anëtar i Universitetit është i detyruar të veprojë me ndershmëri dhe në të mirën e interesit të anëtarëve të tjerë të institucionit dhe të publikut të gjerë. Çdo anëtar i Universitetit përmbush detyrimet, që rrjedhin nga anëtarësimi në komunitetin universitar.

3. Parimi i drejtimit profesional dhe i kodit të paraqitjes:

- a. Çdo anëtar i Universitetit është i detyruar të përmbushë tërësisht përgjegjësitë e tij, në kohën e duhur dhe me aftësitë e tij më të mira. Ai duhet të shmanget nga çdo veprimtari që mund të dëmtojë Universitetin dhe reputacionin e tij;
- b. Paraqitja e jashtme e stafit mësimdhënës është çështje e rëndësishme. Pavarësisht zgjedhjes individuale në veshje dhe paraqitje, anëtarët e tij inkurajohen të bëjnë zgjedhje të veshjes dhe paraqitjes në përshtatje me mjedisin universitar.

4. Parimi i respektimit të ndërsjellë të anëtarëve të Universitetit

Gjatë veprimeve të përditshme, çdo anëtar i Universitetit duhet të jetë bashkëpunues, i sjellshëm dhe i durueshëm. Ai duhet t'i drejtohet anëtarëve të tjerë me respekt dhe të shmangë çdo sjellje mëndjemadhësie, nënvlerësuese dhe intolerance.

KREU II

Stafi akademik dhe stafi administrativ

1. Parimi i objektivitetit:

- a. Çdo anëtar i stafit akademik ose stafit administrativ nuk duhet të niset nga paragjykimi, favorizimi, sikundër nga ndikime të tjera, që mund të çënojnë objektivitetin e tij;
- b. Çdo anëtar i stafit akademik ose stafit administrativ, në komunikimin dhe prezantimin brenda kampusit të Universitetit dhe jashtë tij, kur përfaqëson Universitetin apo vepron në emër të tij, nuk duhet të përdorë grada apo tituj jo të fituar ose që nuk njihen nga legjislacioni shqiptar.

2. Parimi i efikasitetit:

Çdo anëtar i stafit akademik ose stafit administrativ duhet të organizojë punët e tij të përditshme në mënyrë të efektëshme, korrekte dhe sipas rregullave të bashkëpranuara.

3. Parimi i konfidencialitetit:

- a. Çdo anëtar i stafit akademik dhe stafit administrativ është i detyruar të respektojë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë kryerjes së përgjegjësive të tij të punës;
- b. Çdo anëtar i stafit akademik dhe stafit administrativ është i detyruar të mos e përdorë një informacion të tillë për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat është marrë informacioni si dhe të parandalojë çdo pakujdesi apo sjellje të qëllimtë që bën ndryshe.

4. Parimi i shmangies së konfliktit të interesit:

Çdo anëtar i stafit akademik ose stafit administrativ duhet të informojë eprorin e drejtpërdrejtë, për çdo marrëdhënie dhe çështje që mund të përbëjnë konflikt interesi në ushtrimin e përgjegjësive të tij në punë. Kur ekzistojnë konflikte të tilla, anëtari është i detyruar të tërhiqet nga proceset vendimmarrëse ose veprimtari të ngjashme (*sipas Statutit të Universitetit*).

5. Parimi i luftës kundër nepotizmit:

Çdo anëtar i stafit akademik ose stafit administrativ duhet në çdo rast të shmangë ose të kundërshtojë ndërhyrje, veprime ose propozime që kanë të bëjnë me nepotizmin.

6. Parimi i ndalimit të marrjes së dhuratave:

Çdo anëtar i stafit akademik ose stafit administrativ nuk duhet, drejtpërdrejt apo tërthorazi, të kërkojë ose marrë, apo të orvatet të kërkojë a të pranojë dhurata apo shërbime nga persona të tretë, me qëllim që të përfitojë trajtim të privilegjuar të çdo lloj natyre, për veten apo për të tjerët.

7. Parimi i përfaqësimit publik:

- a. Kur anëtari i stafit akademik ose stafit administrativ përfaqëson Universitetin, në një debat apo lloj veprimtarie tjetër publike, deklaratat e tij duhet të jenë në përputhje me politikat e Universitetit.
- b. Çdo anëtar i stafit akademik ose stafit administrativ duhet të verë në dijeni dhe të marrë miratim nga autoritetet drejtuese të Universitetit, përpara se të bëjë publike në media (TV, radio, gazetë, rrjete sociale etj.) informacione lidhur me strategjinë dhe politikat promovuese të Universitetit.

8. Parimi i konkurrencës së drejtë:

Anëtari i stafit akademik ose stafit administrativ asnjëherë nuk duhet të prononcohet apo të përcjellë informacion të pasaktë në lidhje me anëtarët e Bordit të Aksionarëve, Bordit të Universitetit ose përfaqësues të tjerë si dhe për veprimtaritë, menaxhimin dhe shërbimet e ofruara nga Universiteti ose nga institucione të tjera të arsimit të lartë, me qëllim dobësimin ose dëmtimin e reputacionit dhe të konkurrencës së ndershme.

KREU III

Stafi akademik

1. Anëtarët e stafit akademik, të udhëhequr nga bindja e thellë për vlerën e njohurive të përparuara, të dinjitetit që të jep profesionalizmi, dhe që kanë pranuar përgjegjësitë e veçanta që u janë dhënë, duhet:
 - a. të jenë edukatorë dhe studiues të efektshëm, të përkushtojnë energjinë e tyre për të zhvilluar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme aftësitë dhe kompetencat e tyre studiuese;
 - b. të ushtrojnë vet-disiplinë dhe gjykim kritik në përdorimin, dhënien dhe transmetimin e njohurive;
 - c. të përcaktojnë vlerën dhe karakterin e punës, që kryejnë jashtë Universitetit në përputhje me përgjegjësitë që kanë brenda tij. Ata duhet të çmojnë domosdoshmërinë e këtyre detyrimeve, duke marrë parasysh përgjegjësitë e veta ndaj studentëve që edukojnë, profesionit dhe ndaj Universitetit.

2. Duke patur parasysh detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i përbashkët në komunitetin e profesoratit dhe të kërkuesve, anëtarët e stafit akademik duhet:
 - a. të respektojnë dhe të mbrojnë informimin e lirë të kolegëve dhe bashkëpunëtorëve të tyre;
 - b. të tregojnë respekt për opinionet e të tjerëve gjatë shkëmbimit të ideve dhe të mendimit kritik;
 - c. të pranojnë detyrimet akademike dhe të bëjnë përiqen të jenë objektive në gjykimin profesional për kolegët;
 - d. të pranojnë pjesëmarrjen në përgjegjësitë e stafit akademik për drejtimin e Universitetit.

KREU IV

Studentët

1. Ndërkohë që studentët janë forca lëvizëse e Universitetit, ata duhet të japin shembujt e sjelljeve të përgjegjshme e të marrin përgjegjësinë që në të gjitha veprimtaritë mësimore dhe veprimtari të tjera, do të kontribuojnë për të krijuar kulturën se mjedisi i Universitetit është një vend i sigurtë, miqësor dhe gjithëpërfshirës për ata që studiojnë atje.
2. Puna e studentëve duhet të përfaqësojë përpjekjet e tyre vetiake dhe të pasqyrojë rezultatet e të mësuarit, punës së pavarur dhe të menduarit kritik.
3. Studentët duhet të shmangin veprime të dënueshme, si plagjiatura, përvehtësimi i punës së tjetrit, vjedhja, mashtrimi dhe çdo veprim tjetër, që parashikohet në Rregulloren e Universitetit.

KREU V

Dispozita të veçanta mbi plagjiaturën

Plagjiatura haset në të gjitha rastet, kur një Anëtar i Universitetit, student apo pedagog, në mënyrë të qëllim të, përdor idetë e dikujt tjetër ose materiale të tjera origjinale (jo njohuri të zakonshme), pa bërë të njohur burimin e tyre.

Studentët që me veprimet e tyre kryejnë plagjiaturë, janë fajtorë për shkelje akademike.

Universiteti inkurajon dhe ndihmon anëtarët e tij të kryejnë kërkime, duke respektuar etikën akademike, dhe shmangur çdo veprim që përbën plagjiaturë. Universiteti ka për detyrë të investigojë dhe penalizojë çdo rast të mundshëm të pandershmërisë akademike.

KREU VI

Dispozita të fundit

Çdo Anëtar i Universitetit duhet të zgjidhë me mirëkuptim, drejtësi dhe qetësi mosmarrëveshjet dhe keqkuptimet që mund të krijohen gjatë komunikimit me të tjerë.

Nënvleftësimi i dispozitave të mësipërme nënkupton përgjegjësi disiplinore për Anëtarin e Universitetit.

Autoriteti përgjegjës, për trajtimin e shkeljeve të këtij Kodi dhe për penalizimet e mundshme, është Komisioni i Etikës, që vepron në përputhje me “Rregulloren mbi Procedurën dhe Masat Disiplinore”.

Komisioni i Etikës një është organ *ad hoc*, ngritja dhe funksionimi i të cilit rregullohet me rregullore të veçantë.

Miratuar nga Bordi i Universitetit Marin Barleti

më 19.11.2010